

**Akti I Mbrojtjes Nderkombetare, 2015 – Sqarime persa I perket afatit te fundit te kthimit te pyetesorit per aplikim per Mbrojtje Nderkombetare (IPO 2) – JU LUTEM KLIKONI NE KETE LINK DHE LEXONI.**

Akti i Mbrojtjes Nderkombetare, 2015 ka filluar me 31 Dhjetor 2016 dhe siguron paraqitjen e nje procedure te vetme e cila ju mundeson te gjitha opsionet e kerkeses suaj per Mbrojtje Nderkombetare ( per statusin e refugjatit dhe per mbrojtje te shtese) dhe lejen per te qendruar ne shtet per arsye te tjera qe do shqyrtohen ne nje process te vetem.

Zyra e Mbrojtjes Nderkombetare eshte vene ne dijeni te disa paqartesive qe jane krijuar lidhur me afatin e fundit per kthimin e pyetesoreve mbi aplikimin per Mbrojtje Nderkombetare (IPO 2) e cila u eshte derguar aplikanteve e shoqeruar nga disa masa tranzitore ne akt gjate javeve te fundit. Kjo zyre ka shkruar tashme tek aplikantet dhe tek keshilltaret ligjore te tyre duke i informuar ata qe aplikimi per Mbrojtje Nderkombetare (IPO 2) duhet kthyer **“nese eshte e mundur, jo me vone se 20 dite pune nga data qe eshte shenuar ne letren shoqeruese”**.

**Per shmangje te ndonje dyshimi, aplikantet dhe keshilltaret ligjore te tyre duhet te kene parasysh qe kjo date kthimi eshte krejtesisht nje afat administrativ per fillimin e procesit te procedures se cdo aplikimi sa me shpejt te jete e mundur. Fleksibiliteti eshte mundesuar nga zyra e Mbrojtjes Nderkombetare neqoftese do duhej me shume kohe per kompletimin e pyetesorit dhe krijimine mundesise per marrjen e ndihmes ligjore neqoftese do nevojitej.**

Aplikantet jane te keshilluar gjithashtu qe nese ata ose keshilltaret e tyre ligjore kane nevojte te mundesojne informacione suplementare tek zyra e Mbrojtjes Nderkombetare pasi ato kane dorezuar pyetesoret per Mbrojtje Nderkombetare, ata mund te bejne nje gje te tille, nese eshte e mundur, jo me vone se dy jave nga data e intervistes se tyre te planifikuar. Ky afat kohor do te krijojte mundesine e perkthimit te dokumenteve neqofte se nevojitet dhe siguron qe intervistusi i IPOs ka te gjithë materialin e duhur ne dispozicion perpara dates se intervistes.

Zyra e Mbrojtjes Nderkombetare shpreson qe ky informacion tu jape mundesine dhe qartesine e nevojshme gjithe aplikanteve.

Neqoftese keni ndonje paqartesi ose pyetje ju lutem kontaktoni qendren e Customer Service duke derguar email: [info@ipo.gov.ie](mailto:info@ipo.gov.ie) ose duke na kontaktuar me telefon ne numrin: (01) 6028008